


REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E BULIQËSISË,
ZHVILLIMIT RURAL DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE
MINISTRI



Nr. 1144 Prot.

Tiranë, më 18 2 2014

UDHËZIM

Nr. 1, Datë 18 2 2014

PËR

ENZIMAT USHQIMORE

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe të nenit 41 të ligjit nr 9863 date 28.01.2008 "Për Ushqimin" i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Ky udhëzim përcakton rregullat mbi enzimat ushqimore të përdorura në ushqime, përfshirë enzimat që përdoren si ndihmëse në procesin e përpunimit, me qëllim për të siguruar funksionimin efektiv të tregut të brendshëm, sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe interesave të konsumatorit, praktikat e drejta në tregtinë e produkteve ushqimore si dhe mbrojtjen e mjedisit.

2. Ky udhëzim do të zbatohet për enzimat ushqimore të përcaktuara në pikën 3 të tij. Gjithashtu, udhëzimi do të zbatohet pa paragjykuar legjislacionin në fuqi në lidhje me rregulla të caktuara në përdorimin e enzimave ushqimore:

(a) në ushqimet specifike;

(b) për qëllime të tjera përveç atyre që përcaktohen nga ky udhëzim.

Ky udhëzim nuk zbatohet për enzimat ushqimore edhe kur ato janë përdorur në prodhimin e:

(a) aditivëve ushqimore;

(b) ndihmësve të procesit të përpunimit,

(c) kulturave mikrobiale që janë përdorur tradicionalisht në prodhimin e disa ushqimeve dhe të cilat rastësisht mund të prodhojnë enzima, të cilat nuk janë përdorur në mënyrë specifike për të prodhuar ato ushqime.

3. Termat e përcaktuar në nenin 3 të ligjit nr. 9863, datë 28.1.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë udhëzim, ndërsa me termat e mëposhtëm do të kuptohet:

(a) "enzimë ushqimore" është një produkt i përftuar nga bimë, kafshë ose mikro-organizma apo

produkte të tyre, duke përfshirë edhe një produkt të përftuar nga një proces fermentimi në të cilin janë përdorur mikro-organizma:

(i) që përmban një ose më shumë enzima të afta të katalizojnë një reagim specifik biokimik.

(ii) të shtuara në ushqim për një qëllim teknologjik në çdo fazë të prodhimit, përpunimit, përgatitjes, trajtimit, paketimit, transportit ose ruajtjes së ushqimit;

(b) "përgatitja e enzimës ushqimore" është një formulim i përbërë nga një ose më shumë enzima ushqimore në të cilën substanca të tilla si aditiv ushqimor dhe/ose përbërës të tjerë ushqimor janë inkorporuar për të lehtësuar ruajtjen, shitjen, standardizimin, hollimin ose shpërbërjen e tyre.

4. Një enzimë ushqimore apo një produkt ushqimor, në të cilën është përdorur një enzimë ushqimore, vendoset në treg vetëm nëse përdorimi i enzimës ushqimore është në përputhje me kushtet e përgjithshme dhe specifike të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij udhëzimi.

5. Një enzimë ushqimore mund të përdoret si e tillë vetëm nëse ajo plotëson kushtet e mëposhtme dhe, kur është e përshtatshme, edhe faktorë të tjerë të pranueshëm:

(a) mbi bazën e të dhënave shkencore të vlefshme, nuk përbën shqetësim në aspektin e sigurisë për shëndetin e konsumatorit në nivelin e propozuar të përdorimit;

(b) ka një nevojë teknologjike të arsyeshme për përdorim;

(c) përdorimi i saj nuk e keqorienton konsumatorin. Mashtrimi i konsumatorit përfshin, por jo vetëm, çështjet që lidhen me natyrën, freskinë dhe cilësinë e përbërësve të përdorur. natyralitetin e produktit, procesin e prodhimit dhe cilësitë ushqyese të produktit.

6. Enzimata ushqimore që vendosen në treg duhet të kenë të specifikuar:

(a) emrin;

(b) specifikimet e enzimës ushqimore, duke përfshirë origjinën e saj, kriterin e pastërtisë dhe çdo informacion tjetër të nevojshëm;

(c) ushqimet në të cilat enzima ushqimore mund të shtohet;

(d) kushtet në të cilat enzima ushqimore mund të përdoret. Kur është e përshtatshme, nuk vendoset asnjë nivel maksimal fiks për përdorimin e një enzime ushqimore. Në këtë rast, enzima ushqimore do të përdoret në përputhje me parimin e *sasisë së dëshirueshme*:

(e) kur është e përshtatshme, nëse ka ndonjë kufizim në shitje të enzimës ushqimore direkt tek konsumatori përfundimtar;

(f) aty ku është e nevojshme, kërkesat specifike në lidhje me etiketimin e ushqimit në të cilin është përdorur enzima ushqimore me qëllim për tu siguruar që konsumatori përfundimtar është i informuar mbi gjendjen fizike të ushqimit ose mbi trajtimin specifik që ai ka kaluar.

7. Enzimata ushqimore dhe përgatitjet e enzimave ushqimore të cilat nuk janë për qëllim shitje tek konsumatori përfundimtar, pavarësisht nëse shiten veçmas ose të përziera me njëra-tjetren dhe/ose përbërës të tjerë ushqimor, siç përcaktohet në Nenin 6 pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1344 datë 10.10.2008 "Për miratimin e rregullores "Për etiketimin e produkteve

ushqimore”, mund të tregtohen vetëm me etiketimin e përcaktuar në nenin 11 të vendimit të lartpërmendur, i cili duhet të jetë lehtësisht i dukshëm, i lexueshëm dhe i pashlyeshëm. Informacioni i dhënë në etikete të jetë lehtësisht i kuptueshëm për blerësit. Ai duhet të jetë në gjuhën shqipe. Kjo nuk e përjashton mundësinë e dhënies së këtij informacioni edhe në një gjuhë tjetër krahas gjuhës shqipe.

8. Etiketimi i enzimave ushqimore dhe përgatitjeve të enzimave ushqimore të cilat nuk janë të destinuara për tu shitur tek konsumatori i fundit duhet të plotësojë kërkesat e përgjithshme si më poshtë:

(a) Kur enzimat ushqimore dhe përgatitjet e enzimave ushqimore nuk janë të destinuara për tu shitur tek konsumatori i fundit, pavarësisht nëse shiten veçmas ose të përziera me njëra - tjetrën dhe/ose përbërës të tjerë ushqimorë, amballazhi i tyre ose konteneriet do të mbajnë informacionin e mëposhtëm:

(i) emri i përcaktuar sipas kësaj rregulloreje për çdo enzimë ushqimore ose një përshkrim i shitjes e cila përfshin emrin i secilës enzimë ushqimore ose në mungesë të një emri të tillë, emrin e pranuar në nomenklaturën e bashkimit Ndërkombëtar të Biokimisë dhe Biologjisë Molekulare (IUBMB);

(ii) përcaktimin “për ushqim” ose “përdorim të kufizuar në ushqim” ose një referencë më specifike për qëllimin e përdorimit të tij në ushqim;

(iii) nëse është e nevojshme, kushtet e veçanta të ruajtjes dhe/ose përdorimit;

(iv) një shenjë identifikuese të ngarkesës ose lot-it;

(v) udhëzimet për përdorim, nëse mosdhënia e tyre do të pengojë përdorimin e duhur të enzimës ushqimore;

(vi) emri ose emri i biznesit dhe adresa e prodhuesit, amballazhuesit apo shitësit,

(vii) një tregues i sasisë maksimale të çdo komponenti ose grup komponentësh që i nënshtrohen kufizimit sasior në ushqim dhe/ose informacione të tjera të përshtatshme në terma të qarta dhe lehtësisht të kuptueshme për të mundësuar blerësit të veprojnë në përputhje me këtë udhëzim; i njëjti

kufizim në sasi vlen edhe për një grup komponentësh të përdorur veçmas ose në kombinim, përqindja e kombinuar e të cileve mund të jepet si një shifër e vetme; kufizimi në sasi mund të shprehet ose numerikisht ose sipas parimit të *sasisë së dëshirueshme*;

(viii) sasia neto;

(ix) aktiviteti i enzimës (ve) ushqimore;

(x) data e jetëgjatësisë minimale ose shënohet “të përdoret deri me...”;

(xi) aty ku është e përshtatshme, informacion mbi një enzimë ushqimore ose substancave të tjera të referuara në këtë nen dhe të listuara në Shtojcën III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1344 datë 10.10.2008 “Për miratimin e rregullores “Për etiketimin e produkteve ushqimore”.

(b) Kur enzimat ushqimore dhe/ose përgatitjet e enzimave ushqimore shiten të përziera me njëra-tjetrën dhe/ose me përbërës të tjerë ushqimorë, amballazhi i tyre ose konteneri të përmbajë një listë të të gjithë përbërësve në rendin zbritës të përqindjes së tyre ndaj peshës së përgjithshme.

(c) Amballazhi ose konteneri i përgatitjeve të enzimave ushqimore të përmbajë një listë të të gjithë komponentëve në rend zbritës të përqindjes së tyre ndaj peshës së përgjithshme.

(d) Pavarësisht përcaktimit në gërmat A, B dhe C të kësaj pike, informacioni i kërkuar në gërmën A gërmat (e) deri (g) dhe në gërmat B dhe C mund të paraqitet vetëm në dokumentet që lidhen me ngarkesat në të cilat treguesi "jo për shitje me pakicë" është vendosur mbi një pjesë lehtësisht të dukshme të amballazhit ose të kontenerit të produktit në fjalë.

(e) Pavarësisht përcaktimit në gërmat A, B dhe C të kësaj pike, kur enzimat ushqimore dhe përgatitjet e enzimave ushqimore janë të futura në çisterna i gjithë informacioni mund të paraqitet vetëm në dokumentet shoqëruese të kësaj ngarkese.

9. Pavarësisht përcaktimit në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 1344 datë 10 10 2008 "Për miratimin e rregullores "Për etiketimin e produkteve ushqimore", enzimat ushqimore dhe përgatitjet e enzimave ushqimore që do të shiten veç ose të përziera me njëra-tjetrën dhe/ose përbërësit e tjerë të ushqimit të destinuar për shitje tek konsumatori përfundimtar mund të tregtohen vetëm nëse amballazhi i tyre përmban informacionin e mëposhtëm:

(a) emri në lidhje me çdo enzimë ushqimore ose një përshkrim i shitjes e cila përfshin emrin i secilës enzimë ushqimore ose në mungesë të një emri të tillë, emri i pranuar në nomenklaturën e IUBMB;

(b) përcaktimi "për ushqim" ose "përdorim i kufizuar në ushqim" ose një referencë më specifike për qëllimin e përdorimit të saj në ushqim.


10. Një prodhues ose përdorues i një enzime ushqimore do të informojë menjëherë Ministrinë dhe AKU-në për çdo informacion të ri shkencor apo teknik të cilat mund të ndikojnë në vlerësimin e sigurisë së enzimës ushqimore.

11. Çdo prodhues apo përdorues i enzimave ushqimore dhe përgatitjeve të enzimave ushqimore duhet të informojë AKU-në për përdorimin aktual të tyre. AKU mban një regjister në lidhje me enzimat ushqimore dhe përgatitjet e enzimave ushqimore që prodhohen, përdoren dhe tregtohen në Republikën e Shqipërisë. Ky regjister duhet të përmbajë informacionin e plotë në lidhje me to dhe produktet ushqimore ku do të përdoren dhe të shërbejë edhe për gjurmueshmërinë e tyre. Regjistri është i aksesueshëm nga Ministria.

12. Ngarkohet Drejtoria e Sigurisë Ushqimore dhe Peshkimit dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI



EDMOND PANARITI